



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

Raporti i Punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

(Janar – Dhjetor, 2022)

Prishtinë, Janar, 2023

Ky raport paraqet punën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL për periudhën Janar – Dhjetor, 2022.

Raporti përshkruan aktivitetet e të gjitha departamenteve/njësive organizative të MAPL-së duke u fokusuar në katër fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor të punës për vitin 2022.

Raporti është hartuar nga Divizioni për Koordinim të Politikave.

Saktësia e të dhënave është përgjegjësi e departamenteve dhe njësive organizative të MAPL-së.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje ekzekutive	5
I. Veprimet e ndërmarra nga MAPL me rastin e shfaqjes së Coronavirusit COVID – 19.....	7
1.1. Veprimet e ndërmarra nga MAPL në raport me komunave me rastin e COVID -19	8
1.2. Identifikimi dhe adresimi i problemeve të shkaktuara nga pandemia COVID 19 në nivelin komunal....	8
II. Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë..	9
2.1. Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal.....	9
2.2. Financimi i projekteve të komunave.....	9
2.3. Vlerësimi i performancës komunale	10
III. Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar.....	11
3.1. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar.....	11
3.2. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar	11
3.2.1. Programi IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020.....	11
3.2.2. Programi IPA II Kosovë-Maqedoni 2014-2020	12
3.2.3. Programi IPA II Kosovë-Mali i Zi 2014-2020	12
3.4. Zbatimi i projektit të bankës botërore “Komunat për të rinjtë”	13
IV. Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale.....	14
4.1. Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore.....	14
4.2. Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale	14
4.3. Monitorimi i kuvendeve të komunave.....	15
4.4. Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane	15
4.5. Koordinimi i politikave.....	16
V. Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve	17
5.1. Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut.....	17
5.2. Hartimi dhe miratimi i Planit Nacional të Veprimit 2022 - 2024 në kuadër Partneritetin për Qeverisje të Hapur - PQH.....	19
5.3. Zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT.....	19
5.4. Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së.....	20
5.5. Krijimi i platformës së kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore	20
5.6. Platforma e brendshme e raportimit.....	20
5.7. Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	21
5.8. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal.....	21
VI. Administrata, financat, auditimi dhe prokurimi	21
6.1. Administrata dhe financat.....	21
6.2. Auditimi i Brendshëm	22
6.3. Prokurimi	23

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
COVID 19	Pandemia e Coronavirusit
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IE	Integrimet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MASHITI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFT	Ministria e Financave dhe Transfere
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PL	Pushteti Lokal
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PQ	Pushteti Qendror
QOMPBP	Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QOE	Qendra Operative Emergjente
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
SDC/DEMOS	Agjencia Zvicereane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjensioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
SMFK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale
SHE	Shtabet Emergjente
SZHEL	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2022, ka realizuar aktivitetet e planifikuara për periudhën Janar – Dhjetor, 2022. Raporti pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara në këtë plan, të integruara edhe në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2022, Planit Operacional Strategjik 2022-2025. Aktivitetet e raportuara janë përmbledhur në kuadër të pesë objektivave strategjike të punës, si vijon:

- Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar;
- Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale;
- Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve
- Administrata dhe financat, auditimi dhe prokurimi.

Raporti bazohet në të dhënat e raportuara për aktivitetet e realizuara nga departamentet dhe njësitë/divizionet e MAPL-së, respektivisht:

- Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal;
- Departamentit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar;
- Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
- Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizioni për Komunikim me Publikun;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm;
- Divizioni i Prokurimit.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë marrë për bazë informatat nga njësitë përkatëse të MAPL-së, të cilat janë analizuar dhe janë vendosur sipas objektivave dhe aktiviteteve të caktuara në planin vjetor të punës. Raporti merr për bazë indikatorët sasior dhe cilësor për aktivitetet realizuara dhe është raport mbi aktivitetet e MAPL-së në periudhën Janar - Dhjetor, 2022.

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në periudhën Janar - Dhjetor 2022 ka arritur t'i realizoj aktivitetet e parapara të cilat janë pjesë e planit vjetor të punës së MAPL-së për këtë vit. Ky plan është dokument i bazuar në objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe në dokumentet tjera relevante të qeverisë. Në këtë periudhë është shënuar progres i matshëm në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për vetëqeverisje lokale, përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve komunale, forcimin e transparencës komunale, promovimin e barazisë gjinore, e-qeverisjes, zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët/donatorët përmes projekteve të përbashkëta, bashkëpunimi me shoqërinë civile, përmirësimin e koordinimit ndërsektorial, bashkëpunimin ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar, ngritjen e kapaciteteve profesionale të komunave dhe shumë fusha të tjera.

Pas shfaqjes së Coronavirusit COVID – 19 si pandemi globale, marrjes së masave adekuata nga Qeveria e Kosovës, MAPL ka pasur një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteteve ndërinstitucionale dhe në raport me komunat. Si rrjedhojë e kësaj është realizuar dhe publikuar një hulumtim për të identifikuar problemet dhe efektet e shkaktuara nga pandemia COVID 19.

Në kuadër të zhvillimit të politikave për Vetëqeverisje Lokale, fokusi është vënë në monitorimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe është përgatitur raporti lidhur me implementimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim ekonomik Lokal. Ndërsa, në bashkëpunim me KLLGI ka hartuar modelin për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të komunave dhe udhëzuesin për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal, të cilat janë publikuar edhe në kuadër të web faqes zyrtare të MAPL-së, gjithashtu ka filluar me procesin e hartimit të Planit nacional për zhvillim ekonomik lokal.

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Është bërë lansimi i fondit nga programi CIF 2 dhe CIF, janë realizuar 5 sesione informuese në 5 rajone. Në kuadër të programit CIF 2 janë 7 komuna përfituese për 7 projekte në vlerë prej 1,080,768.38 €. Për projektet infrastrukturore për komunitete janë përzgjedhur 28 projekte në 20 komuna, në vlerë prej 1,000,000.00 €. Për projektet e CIF janë nënshkruar marrëveshjet për 12 projekte. Nga granti i performancës komunale, në vlerë të përgjithshme prej 8,000,000.00 € prej tyre 3,000,000.00 € nga buxheti i MAPL dhe 5,000,000.00 € nga buxheti i donatoreve janë 14 komunat përfituese me 60 projekte, ku nga buxheti i MAPL janë 8 komuna përfituese me 25 projekte dhe nga buxheti i DEMOS janë 6 komuna përfituese me 35 projekte.

MAPL në bashkëpunim me SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmbyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti për performancë komunale për komunat të cilat gjatë vitit 2019 kanë treguar performancë më të lartë në ofrimin e shërbimeve. Për 21 komunat përfituese, nga programi për bashkëfinansim me donatorë bazuar në skemën e grantit për performancë të komunave në bashkëpunim me projektin DEMOS dhe donatorët e tjerë janë financuar 57 projekte në vlerë prej 3,615,474.00€. Ndërsa, ka filluar vlerësimi i komunave për performancën e vitit 2021 ka janë pranuar të dhënat nga komunat, është bërë përpunimi i të dhënave. Sa i përket vlerësimit të performancës së komunave për grantin e performancës për vitin e alokimit 2023, sipas rezultateve të performancës së vitit 2021, është hartuar analiza për kushtet minimale të GPK-së. Qeveria ka provuar nisma për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare për GPK, është themeluar grupi negociatorë, është hartuar draft-marrëveshja, dhe pas finalizimit do të dërgohet për miratim në kuvend.

Në këtë vit ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Kosovë – Shqipëri, Kosovë – Maqedoni dhe Kosovë – Mali i Zi. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 iniciativa/nisma, për bashkëpunim ndërkomunal, dhe 7 iniciativa/nisma për bashkëpunim komunal ndërkombëtar, ndërsa janë nënshkruar 2 marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal dhe 2 marrëveshje për bashkëpunim komunale

ndërkombëtare. Gjithashtu, është vlerësuar një iniciativë për binjakëzim të Komunës së Pejës me Komunën e Kirklareli- Republika e Turqisë.

Në kuadër të projektit M4Y është bërë shtrirja dixhitale dhe mediatike duke krijuar 13 postera dixhitale me të rinjtë dhe me fokus tek gratë, me qëllim që të inkurajohen dhe të aplikojnë për trajnime dhe grante dhe janë përzgjedhur 50 komunitete të synuara të cilat kanë filluar aktivitetet e mobilizimit dhe shtrirjes në të gjitha komunat. Është bërë formimi i grupeve të të rinjëve për ciklin parë të granteve, dhe është bërë identifikimi i drejtuesve të të rinjëve. Është bërë shqyrtimi i nënprojekteve për provueshmëri për ciklin e parë të granteve. Është bërë themelimi i komiteteve të vlerësimit të nëngranteve, është bërë thirrja për propozime për subgante për adoleshent (15-18), dhe për të rritur (18-24) për ciklin e parë të granteve, si dhe është paraqitur lista e fituesve të subgranteve për ciklin e parë të granteve. Është dizajnuar web-faqja e internetit M4Y, e cila do të lansohet në tetor të këtij viti. Thirrja e Parë për Propozime është hapur në dhjetë komuna partnere në muajin maj 2022. Janë pranuar 185 aplikime.

Në këtë vit, MAPL fokus të veçantë i ka dhënë akteve ligjore dhe nënligjore në programin legjislativ për vitin 2022 dhe dokumenteve tjera, përfshirë këtu hartimin e dy koncept dokumenteve dhe një vlerësimi ex-post, si dhe ndryshim/plotësimin 4 akteve nënligjore. MAPL ka përmbyllur Studimin e Fizibilitetit për Qeverisje Lokale, gjithashtu në këtë vit është hartuar edhe raporti dhe programi i orientimeve afatmesme dhe afatgjate të sistemit të qeverisjes lokale, të cilat janë përcjellë për miratim në qeveri. Qeveria i ka shqyrtuar dokumentet e lartpërmendura dhe janë publikuar. Është hartuar model plani për integritet për komuna dhe doracaku për zbatimin e planit për integritet në komuna.

Në periudhën Janar –dhjetor 2022, kanë funksionuar 38 komuna të Republikës së Kosovë, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Kuvendet e komunave kanë mbajtur 513 mbledhje. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 2280 akte, prej tyre 107 rregullore dhe 2173 vendime. Nga gjithsej 2280 akte, MAPL ka vlerësuar 1160 akte, përdërisa 1120 akte të tjera janë dërguar në Ministrinë e Linjës.

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, në total janë pranuar 13 akte ligjore dhe nënligjore prej tyre: Projekt Ligje 2, Projekt Rregullore 1, 8 Projekt Udhëzime Administrative dhe 2 koncept dokumente. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar dhe shqyrtuar 70 kërkesa dhe 10 ankesa nga personat fizik dhe juridik.

Me qëllim të pasqyrimin të aktiviteteve të zhvilluara nga kuvendet e komunave është hartuar dhe publikuar Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave për periudhën Janar – Dhjetor 2021, dhe janar – qershor, dhe korrik – shtator 2022. Në bashkëpunim me misionin e OSCE-së në Kosovë, është hartuar plani i integritetit për komuna dhe doracaku/udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna. I njëjti është lansuar në kuadër të sesioneve informuese/trajnimeve me komunat të cilat janë mbajtur në muajin maj.

MAPL ka udhëhequr një proces tejet të rëndësishëm për adresimin e obligimeve të agjendës evropiane në komuna. Në këtë periudhë kohore është hartuar Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar-dhjetor 2021, si dhe raporti janar - shtator 2022. Edhe përgatitur raporti periodik për periudhën korrik-shtator 2022 për masat e MAPL-së në kuadër të Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së. Janë identifikuar obligimet e komunave nga PKZMSA dhe janë inkorporuar në planin e përgjithshëm të komunave për përmbushjen e obligimeve të Agjendës Evropiane për vitin 2022. Janë identifikuar konkluzionet e dala nga nënkomiteti për drejtësi liri dhe siguri si dhe është raportuar në Zyrën e Kryeministrit.

Sa i përket fushës së promovimit të barazisë gjinore në komuna, është rritur ndërgjegjësimi i zyrtarëve komunal për nevojën e hapave konkrete në integrimin e perspektivës gjinore në politikat komunale, ku në vazhdimësi MAPL ka bërë përpjekje që komunat të arrijnë sigurimin e përfaqësimit gjinor në përputhje me kuadrin ligjor. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit,

së fundi ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për mbështetje financiare për studentë të komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë.

MAPL ka ofruar informata të vazhdueshme për publikun, mediet, shoqërinë civile, organizatat e huaja ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Kurse, lidhur me qeverisjen e hapur si njëri nga parimet themelore të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nismën e MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillohet me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për qeverise të hapur në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur – PQH. Planit Kombëtar i Veprimit 2023-2025 është hartuar ka kaluar në dy proceset e konsultimit paraprak dhe konsultimit publik deri me datën 30 shtator 2022 dhe është miratuar nga Qeveria.

MAPL ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Në bashkëpunim me DEMOS janë hartuar Termat e Referencës për angazhimin e ekspertit për studimin e fizibilitetit për platformën E-KOMUNAT, si dhe janë arritur që të nënshkruhen marrëveshjet e bashkëpunimit me Akademinë për E-Qeverisje të Estonisë për zhvillimin e platformës E-KOMUNA. Me 02 shtator 2022 është bërë lansimi i platformës E-KOMUNAT në kuadër të portalit shtetëror E-KOSOVA.

Sa i përket koordinimit të politikave, ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Po ashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me Forumin Konsultativ për Qeverisje Lokale, e cila është “storie suksesi” dhe si e arritur është përmendur edhe në Raportin e Vendit 2021 për Kosovën nga Komisioni Evropian. Janë zhvilluar takime me departamente dhe njësitë organizative të MAPL-së për koordinimin e aktiviteteve të planifikuara në vitin 2022 dhe ka përfunduar hartimi i planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2023 i cili është dërguar në sekretariatit koordinues të qeverisë, i njëjti është publikuar edhe në kuadër të web faqes zyrtare të MAPL-së. Në këtë periudhë është bërë identifikimi i prioriteteve afatmesme strategjike, është hartuar Planit Kombëtar për Zhvillim, 2023-2025. Kemi hartuar Planin e Integritetit për MAPL. Dhe kemi hartuar model planin e integritetit për komuna dhe doracaku/udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna. I njëjti është përkthyer në gjuhët zyrtare dhe do të lansohet në kuadër të (5) pesë sesioneve informuese me komunat të cilat janë mbajtur gjatë muajit maj. Janë organizuar 6 trajnime konform programit dhe kornizës kohore të planifikuara. Në bashkëpunim me IKAP dhe me mbështetjen e OSBE-së, janë organizuar trajnime 1 ditore në 5 regjionet e Kosovës, lidhur me Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna.

Buxheti i MAPL-së për vitin 2022, (bazuar në raport të datës 05.01.2023) së bashku me Donacionet (93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore) është 7,799,564.44 €. Nga kjo shumë, nga buxheti i MAPL-së janë shpenzuar 4,190,507.22 € ose 69.75% e buxhetit. Në kategorinë e donacioneve, nga 93 Council of Europe, janë shpenzuar 155,971.64 € ose 74.97% e buxhetit, ndërsa nga donacioni i WB-Banka Botërore janë shpenzuar 718,933.00 ose 45.41%. Në total Buxheti i MAPL-së dhe Donacionet është shpenzuar në vlerë prej, 5,064,411.86 ose 64.94%.

Në fushën e Auditimit, gjatë kësaj periudhe, kanë mbajtur 2 takime të Komitetit të Auditimit. Është përfunduar procesi i auditimit: “Menaxhimi i pasurisë në MAPL”, procesi i Auditimit “Menaxhimi i listës së pagave në MAPL”. Gjithashtu, është bërë auditimi: “Sistemi i Menaxhimit të Prokurimit”, raporti i është dërguar akterëve. Në këtë raport është dhënë një (1) rekomandim. Njësia e audituar ka përgaditur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Është në proces të Auditimit “Sistemi i menaxhimit të buxhetit”, dhe auditimi ad-hoc “Përmbushja e obligimeve të kontraktuara për mirëbajtje të ueb faqeve” që ka filluar më 01.09.2022.

Ndërsa, si i përket prokurimit, gjatë periudhës, janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara si: **Kontrata për Furnizim** (furnizim për zyrë, furnizim për zyrë për BNK, furnizim me IT, furnizim me IT për BNK, dhe furnizim me paisje tjera të IT), **Kontrata për Shërbime**, (shërbime për pastrimin e veturave, kontrollimin teknik dhe sigurimin e veturave).

I. Veprimet e ndërmarra nga MAPL me rastin e shfaqjes së Coronavirusit COVID – 19

Pas shfaqjes së coronavirusit COVID – 19 si pandemi globale, institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë masat adekuate dhe të nevojshme për parandalimin e përhapjes së tij.

1.1. Veprimet e ndërmarra nga MAPL në raport me komunave me rastin e COVID -19

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform përgjegjësive që ka dhe sipas objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, misionit dhe vizionit, gjatë kësaj periudhe rol të rëndësishëm i ka kushtuar edhe komunave, me qëllim të përkrahjes dhe marrjes së masave adekuate për parandalimin e pandemisë globale të COVID -19. Në këtë drejtim, MAPL ka adresuar një sërë kërkesash dhe njoftimesh tek kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve të komunave, Qendra Operative Emergjente (QOE), Qendra Operative e MPBAP (QOMPAP) dhe Qendrën për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve (QPKS), si dhe në institucionet tjera.

Po ashtu, MAPL ka zhvilluar takime virtuale koordinuese me kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës, me qëllim të diskutimit të masave të reja lidhur me pandeminë COVID – 19 dhe tejkalimin e sfidave bashkërisht.

1.2. Identifikimi dhe adresimi i problemeve të shkaktuara nga pandemia COVID 19 në nivelin komunal

Në kuadër të këtij aktiviteti, është realizuar studimi lidhur me problemet e shkaktuara nga pandemia, Covid-19. Pasi janë realizuar punëtorit rajonale lidhur me të dhënat e komunave, bizneseve dhe OJQ-ve për problemet e shkaktuara nga pandemia Covid-19, si dhe pas zhvillimit të hulumtimit empirik në terren, ekspertët e angazhuar UN-HABITAT kanë përpunuar të dhënat të cilat janë në kuadër të këtij studimi. **Në këtë vit është përgatitur Raporti lidhur me problemeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19 në nivelin lokal, i cili është publikuar me 08 shtator, 2022.**

II. Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë

Aktivitetet e realizuara në kuadër të objektivit të parë, janë grupuar në 3 fusha kryesore si vijon:

- Hartimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal;
- Financimit të projekteve të komunave;
- Menaxhimi i performancës komunale.

2.1. Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal

MAPL në baza vjetore monitoron dhe raporton për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik lokal 2019 – 2023. Për këtë qëllim është dërguar shkresa tek komunat dhe ministritë e linjës për të raportuar lidhur me realizimin e aktiviteteve të dala nga plani i veprimit të SZHEL. Janë marr të dhënat nga 31 komuna dhe nga Ministritë e Linjës, si dhe është përgatitur raporti i planit të veprimit, i cili është dërguar në ZKM-ZPS. Është hartuar model strategjia për zhvillim ekonomik lokal të komunave dhe udhëzuesi për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal, të cilat janë publikuar edhe në kuadër të ëeb faqes zyrtare të MAPL-së. Është përgatitur drafti final i model-profileve ekonomike të komunave i cili është diskutuar me Drejtoret Komunal për Zhvillim Ekonomik në takimin mbajtur me datën 23.09.2022. dokumenti është finalizuar dhe është dërguar tek komunat.

Sa i përket Hartimit të Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2029, në muajin shkurt është nxjerrë vendimi për themelimin e grupit punues për Hartimin e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2029. Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta, ku janë përgatitur dy pyetësor njeri për komuna dhe tjetri për biznese. Nga këta pyetësor kemi pranuar 31 përgjigje nga komunat dhe 57 përgjigje nga bizneset. Janë analizuar të gjetjeve nga pyetësorët, janë organizuar takim me drejtoret e zhvillimit ekonomik të komunave të Kosovës, si dhe në muajin dhjetor, Grupi Punues ka përgatitur draft-planin, i cili do të finalizohet dhe miratohet në gjysmën e parë të vitit 2023. Ndërsa, lidhur me përgatitjen e rekomandimeve për avancim të proceseve buxhetore komunale, është përgatitur shkresa me propozimet e MAPL dhe e njëjta i është dërguar zyrës së Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me propozimet nga MAPL. Gjithashtu, janë realizuar tri punëtori rajonale për përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nëpër komuna.

- Është hartuar raporti i shpenzimeve të komunave për vitin 2021;
- Raporti i të hyrave vetanake të komunave për vitin 2021;
- Raporti i investimeve kapitale në komuna për vitin 2021;
- Raporti lidhur me rekomandimet e auditorit gjeneral për komuna për vitin 2021;
- Draft raporti përmbledhës për vitet 2008/2021; dhe
- Draft raporti përmbledhës për vitet 2019/2021; dhe
- Është përgatit vlerësimi i ndikimit buxhetor për UA për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.

2.2. Financimi i projekteve të komunave

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. MAPL ka përgatitur kriteret për aplikim të financimit të projekteve të komunave në bazë të programit të CIF 2, si dhe janë përgatitur kriteret e programit tjetër për mbështetje lidhur me projektet infrastrukturore për komunitete në komuna. Është bërë lansimi i fondit nga programi CIF 2 dhe CIF, janë realizuar 5 sesione informuese në rajonet e komunave. Në kuadër të programit

CIF 2 janë pranuar 44 aplikacione nga 35 komuna, ndërsa për projektet infrastrukturore për komunitete në komunat e Kosovës janë pranuar 40 aplikacione nga 20 komuna. Janë vlerësuar aplikacionet për projektet infrastrukturore për komunitete dhe janë përzgjedhur 28 projekte në 20 komuna, në vlerë prej 1,000,000.00 €, janë njoftuar 20 komunat përfituese për 28 projekte, dhe janë nënshkruar marrëveshjet. Ka përfundimtar vlerësimi i aplikacioneve nga paneli shqyrtues i CIF 2, dhe janë njoftuar 7 komuna përfitues për 7 projekte në vlerë prej 1,080,768.38 €. Për projektet e CIF janë nënshkruar marrëveshjet për 12 projekte. Nga granti i performancës komunale, në vlerë të përgjithshme prej 8,000,000.00 € prej tyre 3,000,000.00 € nga buxheti i MAPL dhe 5,000,000.00 € nga buxheti i donatoreve janë 14 komunat përfituese me 60 projekte, ku nga buxheti i MAPL janë 8 komuna përfituese me 25 projekte dhe nga buxheti i DEMOS janë 6 komuna përfituese me 35 projekte.

2.3. Vlerësimi i performancës komunale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë kësaj periudhe, rëndësi të madhe i ka kushtuar avancimit të sistemit të performancës komunale dhe skemës së grantit të bazuar në performancë. MAPL në bashkëpunim me SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmbyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti për performancë komunale për komunat të cilat gjatë vitit 2019 kanë treguar performancë më të lartë në ofrimin e shërbimeve. Për 21 komunat përfituese, nga programi për bashkëfinancim me donatorë bazuar në skemën e grantit për performancë të komunave në bashkëpunim me projektin DEMOS dhe donatorët e tjerë janë financuar 57 projekte në vlerë prej 3,615,474.00 €, prej tyre nga buxheti i MAPL 24 projekte në 8 komuna në vlerë prej 1,232,744.24 € dhe nga buxheti i projektit DEMOS janë financuar 33 projekte në 21 komuna në vlerë prej 2,383,130.00 €. Ka përfunduar procesi i vlerësimit të komunave për grantin e performancës për vitin e alokimit 2022, sipas performancës së vitit 2020. Është përfunduar vlerësimi i komunave për performancën e vitit 2021. Sa i përket vlerësimit të performancës së komunave për grantin e performancës për vitin e alokimit 2023, sipas rezultateve të performancës së vitit 2021, është hartuar analiza për kushtet minimale të GPK-së. Qeveria ka provuar nisim për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare për GPK, është themeluar grupi negociatorë, është hartuar draft-marrëveshja, dhe pas finalizimit do të dërgohet për miratim në kuvend.

III. Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Aktivitetet në këtë objektiv janë realizuar në drejtim të:

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar;
- Zbatimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar;
- Projekti nga Banka Botërore “Komunat për të rinjtë”.

3.1. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar

Në periudhën Janar - Dhjetor 2022, MAPL ka realizuar aktivitetin e sajë lidhur me mbështetjen e komunave për avancimin e bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar. Me mbështetje të OSBE, janë organizuar pesë (5) punëtori, në rajonin e Pejës, Prizrenit, Prishtinës, Mitrovicë dhe Gjilanit lidhur me procedurat e bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 iniciativa/nisma, për bashkëpunim ndërkomunal, dhe 7 iniciativa/nisma për bashkëpunim komunal ndërkombëtar, ndërsa janë nënshkruar 2 marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal dhe 2 marrëveshje për bashkëpunim komunale ndërkombëtare. Gjithashtu, është vlerësuar një iniciativë për binjakëzim të Komunës së Pejës me Komunën e Kirklareli- Republika e Turqisë. MAPL, ka hartuar Koncept-Dokumentit për Bashkëpunim Ndërkomunal, i cili është dërguar në Qeveri për miratim. Është krijuar data baza për të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar. Më qëllim të avancimit të procesit lidhur me binjakëzimin e komunave të Republikës së Kosovës me komunat/qytetet ndërkombëtare, është organizuar konferenca për bashkëpunim komunal ndërkombëtar/qeverisje vendore ku pjesëmarrës kanë qenë përfaqësuesit e shtetit të IOWA-së.

Në kuadër të programit – Instrumenti për Investime Kapitale (CIF), janë nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit me katër (4) Komuna të Republikës së Kosovës: Marrëveshje e bashkëpunimit ndërkomunal për financimin e projektit “Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe bujqësore” për komunat Istog dhe Pejë si dhe Marrëveshje e bashkëpunimit ndërkomunal për financimin e projektit rekreativo – sportiv me titull “Lugu i verdhë” për komunat Kamenicë dhe Novobërdë.

3.2. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Kosovë – Shqipëri, Kosovë – Maqedoni dhe Kosovë – Mali i Zi.

3.2.1. Programi IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020

Në kuadër të Programit IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020 - Ka vazhduar zbatimi i dy projekteve të kontraktuara nga Thirrja e Dytë: Green Cross – Drejtë ekonomive lokale të gjelbërta me investime të zgjuara me afat kohor: 15 Janar 2020 - 15 Maj 2023 dhe Clean Eater Project - Projekti për ujë të pastër në Gjakovë dhe Kukës me afatin kohor prej: 15 Janar 2020 - 15 Janar 2023. Projekti është në implementim e sipër, janë realizuar vizitat monitoruese tek përfituesit në Kosovë dhe Shqipëri. Kurse, sa i përket Menaxhimi i kontratës së asistencës teknike TAGC është nxjerrë vendimi për përbërjen e re të Komitetit të Përbashkët Monitorues Shqipëri – Kosovë, si dhe përmes procedurës së shkruar është miratuar Raporti vjetor i zbatimit (AIR) për vitin 2021. Janë kontraktuar 4 projektet e përzgjedhura në kuadër të thirrjes së III-të në totalin e shumës financiare 1,600,00.00€, (Rruga drejt përdorimit efikas të burimeve natyrore lokale; Rritja e biodiversitetit në pellgun e lumit Drin përmes Menaxhimit të Integruar të Pellgut Ujëmbledhës – BIODRIN; Rrugët e Eko-Turizmit në Zonën Ndërkufitare për Promovimin e Turizmit Alternativ (ECO ROUTES); Ndërlidhja e Turizmit përmes Trashëgimisë Kulturore dhe Zgjidhjeve Smart në Lezhë dhe Gjakovë. Projektet janë në fillim implementimi, do të publikohen në ueb faqen e Programit. Dokumenti në lidhje me Programimin e IPA III për Programin Shqipëri - Kosovë, është aprovuar me 15 Shtator 2022 nga DGNEAR në Bruksel. Jemi në pritje të pranimit të

dokumentit zyrtare të Programit të Bashkëpunimit Nderkufitare të Shqipëri - Kosovë IPA III, 2021-2027, nga Delegacioni Evropian. Është publikuar në GZ Ligji nr. 08/L-148 për Ratifikimin e “Marrëveshjes Kornizë Financiare të Partneritetit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për Aranzhimet Specifike për Zbatimin e Asistencës Financiare të Bashkimit për Kosovën sipas Instrumentit për Asistencën e Paradherimit (IPA III). Është mbajtur takimi i 8-të i Komitetit të Përbashkët Monitorues - JMC gjatë këtij viti, me datë 10 nëntor 2022. 2) Është miratuar koncepti i notave për thirrjen e katërt për projekt propozime. 3) Të gjitha projektet e thirrjes së tretë kanë filluar implementimin dhe janë në fazën fillestare të realizimit. Gjatë muajit prill – qershor 2022, janë realizuar vizitat monitoruese në të gjitha projektet.

3.2.2. Programi IPA II Kosovë-Maqedoni 2014-2020

Programet e IPA III 2022 - 2027, janë aprovuar dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian. Në kuadër të thirrjes së 4-të për projekt Propozime kanë filluar të zbatohen dy projekte: Projekti “CBCEko kid” përfitues Komuna e Ferizajt në partneritet me komunën e Çairit dhe Projekti “Pilot interventions for easteater treatment and solid waste management in the cross-border region” ku përfitues është Komuna e Novobërdës në partneritet me komunën e Gjorce Petrov. Projekti Prizren-Tetovë "Reviving Crafts and Building Culture for Joint Touristic Development" ka filluar të zbatohet nga muaji qershor 2022. Janë realizuar 10 vizita monitoruese tek projektet e lartpërmendura nga stafi i SPT-së dhe MAPL-së. Janë mbajtur trajnime për përfituesit e projekteve nga thirrja e 4-të, për udhëzimin e përfituesve në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit të bazuara në rregulla të PRAG, raportimin narrativ dhe financiar në kuadër të projekteve të Programit si dhe çështjet tjera që lidhen me rregulla të vizibilitetit. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë organizuar edhe dy trajnime në Prishtinë dhe Shkup në lidhje me ciklin e menaxhimit të projekteve. Është mbajtur Forumi Konsultativë me komunat në kuadër të zonës së Programit të BNK-së KS-MK, më 16 Mars 2022, ku është prezantuar koncepti i thirrjes së 5-të, për projekt-propozime. Është përgatitur pako e udhëzuesit me dokumentet përcjellëse dhe shpallja e thirrjes së 5-të për projekt propozime në kuadër të Programit të BNK-së KS-MK. Ditët informative për aplikuesit potencial janë mbajtur për më 16 gusht në Kosovë/Gjilan dhe 18 gusht në Maqedoni të Veriut/Çair. Procesi i vlerësimit të konceptit notave apo fazës së parë të aplikimit realizohet nga Zyra e BE në Kosovë. Janë mbajtur 2 takime të JMC, më 14 shkurt dhe më 22 dhjetor. Takimi bilateral është mbajtur më 29 shtator 2022. Stafi i JTS ka marrë pjesë në një forum rajonal në Tiranë më 15-18 maj. Paketa e trajnimeve për anëtarët e JMC është përgatitur dhe trajnimet do të realizohen në fillim të vitit 2023. Është aprovuar kërkesa për no cost extension për vazhdimin e zbatimit të TAGC deri më 5 dhjetor 2023. Gjatë muajit shkurt është finalizuar raporti i dytë vjetor i Kontratës (TAGC) së bashku me dokumentet përcjellëse dhe janë dërguar për aprovim në Zyrën e BE në Kosovë. Të njëjtat janë miratuar edhe në takimin e JM Për vitin 2021 C të datës 14 shkurt 2022.

3.2.3. Programi IPA II Kosovë-Mali i Zi 2014-2020

Ka përfunduar procesi i vlerësimit të projekteve në kuadër të thirrjes së tretë. Më 14 dhjetor është mbajtur takimi i JMC ku është dhënë opinion këshilldhënës pozitiv për 10 projekte në vlerën totale prej 3,216,040.59 €, përkatësisht 3 për prioritetin tematik 1 - Promovimi i punësimit, lëvizshmërisë së punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit; 3 për prioritetin tematik 2 - Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut; dhe 4 për prioritetin tematik 3 - Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Kontraktimi i projekteve të përzgjedhura si dhe organizimi i ceremonisë së dhënies së granteve do të realizohen në janar 2023 në Prishtinë. Më datë 26-27 janar 2022 është mbajtur takimi i dytë i Komitetit Drejtues të Programit. Është publikuar numri i dymbëdhjetë i Buletinit për Rritjen e Bashkëpunimit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik për programin e BNK-së Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë, lidhur me projektet e financuara në kuadër të thirrjes së 1 dhe 2 të Programit IPA II. Janë finalizuar dhe publikuar videot promovuese lidhur me projektet e zbatuara dhe atyre që janë në zbatim e sipër të të dyja thirrjeve. Më 14 dhjetor 2022 është mbajtur takimi i 8-të i JMC. TAGC aktuale IPA/2019/409-185 është vazhduar pa kosto shtesë përmes shtojcës nr. 2 deri më 04 prill 2023 ndërsa TAGC e re Nr. IPA/2021/428-797 me alokimin e 2020 në vlerën prej 120 000 € për asistencë teknike në kuadër të IPA II 2014 - 2020 hyn në fuqi nga data 5 dhjetor 2023 dhe përfundon më 5 prill 2024. Programet e IPA III 2022 - 2027,

janë aprovuar dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian. Projekti "Krijimi i punësimit në Bujqësi" në kuadër të Thirrjes së II për Projekt Propozime, (Podgoricë, Tuz, Gollubovc & Pejë/Istog) ka vazhduar aktivitetet sipas planit dhe objektivave të projektit si dhe ka kërkuar zgjatje pa kosto shtesë, e cila është miratuar nga DEU në Mal të Zi. Projekti "Veprime ndërkufitare për sektorin e riprodhimit shëndetësor" në kuadër të Thirrjes së II për Projekt Propozime, (Mal të Zi: Andrijevic, Bar, Berane, Bijelo Polje, Gusinje, Petnjica, Plav, Podgorica, Kolašin, Mojkovac, Rozhaje dhe Ulqin - Kosovë: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Gjakovë) përfundon më 01.03.2023. Projekti "Qendra turistike për një ofertë më të mirë turistike në vendet më pak të avancuara malore" në kuadër të Thirrjes së II për Projekt Propozime, (Andrijevic-Mali i Zi, dhe Deçan-Kosovë) ka vazhduar aktivitetet sipas planit dhe objektivave të projektit si dhe ka kërkuar zgjatje pa kosto shtesë, e cila është miratuar nga DEU në Mal të Zi. Projekti përfundon në maj 2023. Projekti "Trashëgimia kulturore - thesar i rajonit ndërkufitar" në kuadër të Thirrjes së II për Projekt Propozime, (Gusinje-Mali i Zi, dhe Pejë-Kosovë) ka vazhduar aktivitetet sipas planit dhe objektivave të projektit si dhe ka kërkuar zgjatje pa kosto shtesë, e cila është miratuar nga DEU në Mal të Zi. Projekti "PRAXIS" në kuadër të Thirrjes së II për Projekt Propozime, (Berane, Petnjica, Gusinje - Mali i Zi, dhe Gjakovë, Klinë - Kosovë) ka përfunduar të gjitha aktivitetet sipas planit dhe objektivave të projektit. Programet e IPA III 2022 - 2027, janë aprovuar dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Evropian. Marrëveshja dy palëshe ndërinstitucionale për bashkëpunim ndërkufitar me NIPAC Kosova është finalizuar dhe dërguar tek NIPAC për shqyrtim dhe miratim para nënshkrimit nga të dyja palët.

3. 4. Zbatimi i projektit të bankës botërore “Komunat për të rinjtë”

Projekti 'Komunat për të Rinjtë - Komponenti I' ose Projekti M4Y është një grant prej 2.7 milion dollarësh i siguruar nga Qeveria Japoneze përmes Fondit Zhvillimor Social të Japonisë (JSDF), i cili administrohet nga Banka Botërore.

Projekti ka për qëllim rritjen e mundësive socio-ekonomike për të rinjtë e marginalizuar (15-24 vjet) në Kosovë. Përmes këtij projekti komunat e zgjedhura do të adresojnë nevojat socio-ekonomike të të rinjve, duke financuar iniciativat të cilat burojnë nga vet ata, me qëllim rritjen e bashkëpunimit mes të rinjëve dhe institucioneve lokale. Projekti implementohet në 10 komuna, me qëllim që të përmirësojë përfshirjen socio-ekonomike të të paktën 3,000 të rinjve të marginalizuar në komunitetet e cënueshme në Kosovë përmes angazhimit qytetar dhe ngritjes së kapaciteteve dhe aftësive të tyre. Projekti do të implementohet në 10 Komuna, të cilat janë përzgjedhur, si: Junik, Ranillug, Hani i Elezit, Zveçan, Kaçanik, Skenderaj, Rahovec, Glllogoc, Vushtrri dhe Ferizaj. Në kuadër të projektit M4Y janë realizuar 157 takime orientuese ku kanë marrë pjesë 1575 përfituesish, janë realizuar 27 takime tjera për mobilizimin e rrjetit të të rinjve me rreth 349 pjesëmarrës dhe janë trajnuar gjithsej 53 influencues të komunitetit, nga 50 gjithsejtë të synuar. Më tej, është bërë shtrirja dixhitale dhe mediatike duke krijuar 13 postera dixhitalë me të rinjtë dhe me fokus tek gratë, me qëllim që të inkurajohen dhe të aplikojnë për trajnime dhe grante. Është aprovuar Manuali ToT i trajnimeve dhe aneksi i visibilitetit me metodologjinë UPSHIFT, është mbajtur trajnimi për 30 mentorë dhe trajnerë për të gjitha komunat target. Gjithashtu, janë përzgjedhur 50 komunitete të synuara dhe kanë filluar aktivitetet e mobilizimit dhe shtrirjes në të gjitha komunat dhe është bërë pranimi i mbi 2200 aplikimeve për trajnime nga të rinjtë, prej të cilëve 1500 janë trajnuar nga muaji Prill 2022. Janë organizuar punëtori për aplikimin e trajnimit neper komuna dhe janë ndihmuar adoleshentët (15-18) me trajnime per procedurat e aplikimit dhe logjistikën. Kompania implementuese CDF ka mbledhur të dhënat baze për rundin e pare te granteve. Është bërë formimi i grupeve të të rinjëve për ciklin parë të granteve, dhe është bërë identifikimi i drejtuesve të të rinjëve. Është bërë shqyrtimi i nënprojekteve për provueshmëri për ciklin e parë të granteve. Është bërë themelimi i komiteteve të vlerësimit të nëngranteve, është bërë thirrja për propozime për subgante për adoleshent (15-18), dhe për të rritur (18-24) per ciklin e pare te granteve, si dhe është paraqitur lista e fituesve te subgranteve per ciklin e pare te granteve. Është dizajnuar ëeb-faqja e internetit M4Y, e cila do të lansohet ne tetor të këtij viti. Thirrja e Parë për Propozime është hapur në dhjetë komuna partnere në muajin maj 2022. Janë pranuan 185 aplikime. Nga 138 aplikime të pranueshme teknikisht, 94 aplikacione janë përzgjedhur dhe lista e fituesve është publikuar në ëeb-faqet e komunave, dhe janë nënshkruar marrëveshjet trepalëshe me përfituesit. Janë përzgjedhur 255 vullnetare, dhe data-baza me te dhënat e tyre është krijuar, si dhe 51 monitorues të rinj.

IV. Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe që ndërlidhen me përmbushjen e objektivit për avancimin e politikave dhe kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale, për vitin 2022, janë shtrirë në drejtim të:

- Zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar;
- Konsultimit paraprak të akteve sektoriale;
- Takimeve të rregullta me komunat;
- Monitorimit të komunave;
- Adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane;
- Koordinimit të politikave;
- Raporteve të hartuara.

4.1. Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, fokus të veçantë i ka dhënë edhe akteve nënligjore në programin legjislativ për vitin 2022 dhe dokumenteve tjera, të cilat janë në proces të hartimit dhe plotësimit/ndryshimit, si në vijim:

- Vlerësimi Ex post i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës *(është përgatit raporti përfundimtar lidhur me vlerësimin ex post dhe është miratuar nga Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit)*;
- Koncept dokument për Ligjin Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës *(është finalizuar është dërguar në Qeveri për miratim)*;
- Koncept-dokumenti për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim *(është formuar Grupi punues, dhe është hartuar drafti koncepti, tani gjendet në procedurë të konsultimit publik dhe paraprak, do të dërgohet për miratim në Qeveri në tre mujorin e parë të vitit 2023)*;
- Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr.04/2019 për Organizmin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal *(është në proces të finalizimit)*
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e proceduarve për zbatimin e gjuhëve në komuna *(është miratuar dhe ka hyre në fuqi)*;
- Projekt Udhëzimi Administrativ (QRK) për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës *(është miratuar në Qeveri dhe ka hyre në fuqi)*.

4.2. Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale


MAPL ka përmbyllur Studimin e Fizibilitetit për Qeverisje Lokale, gjithashtu në këtë periudhë është hartuar edhe raporti dhe programi i orientimeve afatmesme dhe afatgjate të sistemit të qeverisjes lokale, të cilat janë përcjellë për miratim në qeveri. Qeveria i ka shqyrtuar dokumentet e lartpërmendura dhe janë publikuar. Është hartuar doracaku për konsultimet publike në komuna, model plani për integritet për komuna dhe doracaku për zbatimin e planit për integritet në komuna.

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, në total janë pranuar 50 akte ligjore dhe nënligjore prej tyre: 15 Projekt Ligje, 2 Projekt Rregullore, 28 Projekt Udhëzime Administrative dhe 5 Koncept Dokumente. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar dhe shqyrtuar 250 kërkesa dhe 35 ankesa nga personat fizik dhe juridik.

4.3. Monitorimi i kuvendeve të komunave

Gjatë vitit 2022, kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave të Republikës së Kosovë, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Ne muajin tetor, kryesuesit e kuvendeve dhe anëtarët e kuvendeve nga komuniteti serb, të komunave, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, kanë dhënë dorëheqje, dhe pas kësaj KQZ ka zëvendësuar anëtarët e kuvendeve për komunat Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok, ndërsa për komunat Leposaviq dhe Zveçan ka caktuar zgjedhjet ne Muajin prill 2023 pasi që ne listat e pritjes nuk ka pasur anëtarë për ti zëvendësuar kuvendet aktuale. Pas zëvendësimeve nga KQZ, anëtarët e KK- Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok kanë dhënë betimin siç parashihet me LVL. Kuvendet e komunave kanë mbajtur 511 mbledhje, prej tyre 390 mbledhje të rregullta, 55 mbledhje të jashtëzakonshme, 10 mbledhje urgjente dhe 56 mbledhje solemne. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 2280 akte, prej tyre 107 rregullore dhe 2173 vendime të kuvendeve të komunave. Të gjitha aktet e kuvendeve u janë nënshtruar procesit të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë. Nga gjithsej 2280 akte, MAPL ka vlerësuar 1160 akte, përderisa 1120 akte të tjera janë dërguar në Ministrinë e Linjës.

MAPL, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave, 1079 akte i ka vlerësuar të ligjshme ndërsa 71 akte i ka kthyer në rishqyrtim, nga të cilat komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 61 akte, ashtu siç është kërkuar nga MAPL, ndërsa 10 akte mbesin të pa rishqyrtuara ku për 6 akte është dërguar shkresë në MD për tu kundërshtuar në gjykatë pas kalimit të afatit për rishqyrtim ndërsa 4 akte tjera janë brenda afatit ligjor për rishqyrtim. Sa i përket akteve të dërguara në Ministrinë e Linjës, MAPL në këto ministri ka përcjellë për vlerësim 1120 akte e prej të cilave nga Ministrinë e Linjës 1009 akte janë konfirmuar si të ligjshme ndërsa 111 janë konstatuar të kundërligjshme. Për të gjitha shkeljet e konstatuara, nga Ministrinë e Linjës, janë përcjellë në komuna kërkesat për rishqyrtim duke e njoftuar edhe MAPL-në. Pas pranimit të kërkesave për rishqyrtim, komunat kanë rishqyrtuar 78 akte, për 11 akte të cilat nuk janë rishqyrtuar dhe harmonizuar nga komunat brenda afatit ligjor MAPL më shkresë përcjellëse i ka dërguar në Ministri të Drejtësisë për ti kundërshtuar në gjykatë ndërsa 22 akte tjera nuk janë rishqyrtuar nga kuvendet e komunave



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të komunave dhe aktet e shqyrtuara gjatë vitit 2022.

MAPL, konform mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale monitoron komunat mbi bazën e të cilave harton raporte periodike për funksionimin e komunave. Organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e kompetencave të tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës. MAPL në fund të muajit mars 2022, ka hartuar raportin vjetor të funksionimit të komunave, i cili është dërguar në Qeveri, Presidencë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4.4. Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë koordinimin e aktiviteteve me komuna për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të cilat burojnë nga agjenda e integritimit evropian. Në këtë periudhë kohore është hartuar Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar-dhjetor 2021, Raporti janar - korrik 2022, dhe Raporti periodik për periudhën korrik - shtator 2022 për masat e MAPL-së në kuadër të Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së. Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 56% të aktiviteteve të planifikuara për realizim. Në total komunat kanë arritur t'i përmbushin 62% të obligimeve të komunave që burojnë nga Agjenda Evropiane. Janë identifikuar obligimet e komunave nga PKZMSA dhe janë inkomporuar në planin e përgjithshëm të komunave për përmbushjen e obligimeve të Agjendës Evropiane për vitin 2022. Janë identifikuar konkluzionet e dala nga nënkomiteti për drejtësi liri dhe siguri si dhe është raportuar në Zyrën e Kryeministrit lidhur me masat e ndërmarra nga MAPL lidhur me këto konkluzione. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, MAPL ka qenë pjesëmarrëse e takimit të gjashtë të nën komitetit për drejtësi, liri dhe siguri në kuadër të procesit të stabilizim asociimit. Në muajin tetor kemi pranuar Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2022. Në kuadër të këtij raporti janë identifikuar sfidat e qeverisjes lokale, është përgatit shkresa për Kryetarë të Komunave dhe është përcjell në 38 komuna

Gjithashtu, janë identifikuar dhe propozuar Obligimet e komunave dhe MAPL-së nga PKZMSA, si dhe është raportuar lidhur me përmbushjen e këtyre obligimeve, janë pranuar konkluzionet e Nënkomitetit për Inovacionin, Shoqëri të Informacionit dhe Politikat Sociale, përkatësisht Konkluzionet e Këshillit Ministror për Integrim Evropian, më tej është përgatitur raporti i PZKMSA-së për periudhën Tetor-Dhjetor 2021 dhe është lansuar në platformë, si dhe Inputi i MAPL-së për raportin e KE-së (Korrik 2021- Shtator 2022). Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, sipas kërkesës së ZKM-së është raportuar për periudhën K1, K2 dhe K3 lidhur me zbatimin e masave të MAPL-së në kuadër të Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së.


Në këtë periudhë, MAPL me mbështetje të OSBE-së ka mbajtur këshillimin 4 ditor me ZKIE-të, janë zhvilluar takime me përfaqësues nga donatorët: USAID, OSBE, GIZ, DEMOS, SIDA, UNDP për mbështetjen e aktiviteteve të MAPL-së dhe janë mbështetur njësitë dhe departamentet brenda MAPL-së për përfitimet e projekteve nga fondet e IPA-së, *(plotësimin e katër (4) propozim projekte për IPA 2023-2024)*. Po ashtu, është mbajtur telekonferenca tre ditore lidhur me TAIEX-in misioni për Mbrojtje Civile - Menaxhimin e Fatkeqësive nga Vërshimet, si dhe komunat janë mbështetur sipas kërkesave të tyre për procedurat e instrumentit TAIEX.

Në bashkëpunim me Zyrarët Komunal për Integritime Evropiane është rishikuar Plani Gjithëpërfshirës i Komunave për vitin 2022. Në kuadër të këtij plani komunat kanë raportuar për raportin e përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2022. Gjithashtu me datë 13 Dhjetor 2022 është përcjell shkresa për raportim në 38 komuna për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Janë propozuar masat e MAPL-së për Programin Kombëtar të zbatimit të MSA-së për vitin 2023, dhe është përgatitur Inputi i MAPL-së për Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për periudhën 1 prill – 15 qershor 2022. Është mbështetur komuna e Suharekës për aplikim në instrumentin TAIEX me propozimin "Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve në menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të zeza përmes impianteve të trajtimit të ujërave të zeza", me ç' rast ka përfituar mbështetje nga BE.

4.5. Koordinimi i politikave

Gjatë periudhës të parë të vitit 2022 janë zhvilluar takime me departamente dhe njësitë organizative të MAPL-së për koordinimin e aktiviteteve të planifikuara në vitin 2022 dhe ka përfunduar hartimi i planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2022 i cili është dërguar në sekretariatit koordinues të qeverisë, i njëjti është publikuar edhe në kuadër të web faqes zyrtare të MAPL-së, si dhe kemi hartuar Planin e punës për vitin 2023. Në këtë periudhë është bërë identifikimi i prioriteteve afatmesme strategjike, është hartuar plani 3-vjeçar i punës së MAPL-së, si dhe janë caktuar objektivat strategjike në kuadër të PSO, si dhe është bërë harmonizimi i tij me

KASH-n. Kemi hartuar Planin e Integritetit për MAPL. Në kuadër të kërkesës së pranuar nga Zyra e Kryeministrit për propozimet e nevojave për Young Cell, MAPL ka propozuar 38 Young Cells për secilën komunë. Në bashkëpunim me misionin e OSCE-së në Kosovë, është hartuar model plani i integritetit për komuna dhe doracaku/udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna. I njëjti është përkthyer në gjuhët zyrtare dhe është lansuar në kuadër të (5) pesë sesioneve informuese me komunat të cilat janë mbajtur gjatë muajit maj. Kemi hartuar Planin Kombëtar për Zhvillim, 2023-2025. Kemi hartuar raportin e funksionimit të komunave për vitin 2021, raportin dhe analizën e zbatimit të planit të punës së ministrisë për vitin 2021, dhe raportet periodike 3 mujore për vitin 2022. Gjithashtu, janë hartuar edhe dokumente të tjera, si:



V. Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Monitorimin e fushës së të drejtave të njeriut në komuna;
- Informimi i publikut rreth aktiviteteve të MAPL-së;
- Transparenca dhe llogaridhënia;
- Ngritja e kapaciteteve komunale; dhe
- Bashkëpunimit me shoqërinë civile.

5.1. Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut

MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Është hartuar Raporti vjetor për të drejtat e njeriut për vitin 2021. Raporti përfshinë segmentin e të drejtave të njeriut nga fusha e barazisë gjinore, të drejtat e fëmijëve, dhuna në familje, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e pakicave, parandalimi i trafikimit me njerëz, të drejtat gjuhësore, mbrojtja nga diskriminimi. Është dërguar shkresa të kryetarët e komunave për obligimet e komunave që dalin nga Ligji Kundërdiskriminimit, dhe obligimin e tyre për caktimin e zyrtarit kundërdiskriminimit, (30 komuna kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 8 komuna janë zyrtarë tjerë që e mbulojnë këtë fushë). Janë realizuar vizita në komuna (Mitrovica e Jugut, Gjilan, Gjakovë, Pejë, dhe Mamushë), për të parë për së afërmi zbatimin e obligimeve nga të drejtat e njeriut në nivel lokal. Është mbajtur punëtorja me komunat e rajonit të Pejës: Pejë, Deçan, Istog, Junik dhe Klinë, ku janë diskutuar obligimet e komunave në zbatim të Ligjit për mbrojtje të fëmijës. MAPL, ka sensibilizuar komunat, ku i'u është drejtuar 38 komunave me njoftim për hapjes zyrtare të fushatës një mujore, kundër trafikimit me njerëz. MAPL në kuadër të mandatit të saj ligjor, ka themeluar grupin punues për rishikimin funksional të zyrave komunale për komunitete dhe kthim dhe njësisë për të drejtat e njeriut duke përfshirë këto dy mekanizma në një departament të veçantë për të drejtat e njeriut. Në këtë segment, divizioni për të drejtat e njeriut në MAPL është duke e bërë analizën për ristrukturimin e këtyre mekanizmave në një departament të veçantë. Është hartuar raporti i përgjithshëm. Në shkurt 2023 do të

publikohet analiza e vlerësimit të kapaciteteve të strukturave dhe zyrtarëve komunal në komuna të mandatuara për të punuar me komunitetet jo-shumicë dhe grupet e cenueshme. Kemi hartuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve me dhe pa Pronar. Gjithashtu, MAPL ka hartuar Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në komuna, është miratuar nga Kryeministri dhe ka për qëllim përcaktimin e rregullave të punës, procedurave, përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, në zbatimin e mandatit siç është përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Në këtë drejtim DADNJK ka njoftuar komunat për obligimet e komunave të cilat dalin nga UA në fjalë. Themelimi i ekipit për drejta të fëmijës, është themeluar në komunën e Gjakovës si dhe është hartuar plani i punës së Ekipit.

Janë dërguar tri shkresa në komunat e Republikës së Kosovës ku iu është kërkuar që:

1. Të shpallin muajin prill si muaj FALAS për regjistrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
2. Të përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi si dhe të identifikojnë mënyrën e koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me mekanizmat institucional;
3. Është kërkuar nga komunat që sipas Ligjit për të Drejtat e Fëmijëve nr.06/L084 neni 14 komunat janë të obliguara përmes drejtorive përkatëse të caktojnë një zyrtar për mbrojtjet të fëmijëve.

Lidhur me bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta nga Kalendarit i vitit 2022, i shpallur vit i Personave me Aftësi të Kufizuar, përfaqësueset e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë paraqitur aktivitetet dhe projekt propozimin e ecures së punës në 5 komunave sipas komponentës së katërt (4) nga Kalendarit i aktiviteteve për vitin 2022 *(në identifikimin e pengesave/ barrierave fillimisht, deri te vlerësimi i qasshmërisë së rrugëve-ambientit të hapur apo sheshi, me dizajn dhe kosto)*. Ka filluar aktivitetet në komunat që janë përzgjedhur: Mitrovica e Jugut, Gjakovë, Mamushë, Pejë dhe Gjilan, të propozuara nga MAPL. Ky aktivitetet implementohet në bashkëpunim me ZQM/ZKM, MMPHI dhe komunat. Është hartuar projekt propozimi për ecurinë e punës në identifikimin e barrierave, pengesat e qasjes së PAK. Janë mbajtur takimet me kryetarë të komunave të lartpërmendura. Komunat kanë nxjerr vendimi mbi formimin e komisionit/Grupit Punues, i cili do i identifikon pengesat, barrierat për PAK., dhe do raporton me kosto buxhetore. Në kuadër të kalendarit të aktiviteteve për PAK, Komuna e Gjilanit ka lanësuar gjuhen e shenjave në Ueb -faqen e komunës, si dhe në mbledhjen e kuvendit në komunë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, së fundi ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për mbështetje financiare për studentë të komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë. Qëllimi i këtij Memorandumi është promovimi i edukimit të këto komunitete, nxitja në zhvillim akademik, krijimi i mundësive që studentët të mos i ndërpresin studimet për shkak të kushteve të vështira materiale, si dhe krijimi i brezave të rinj të mësimdhënësve dhe ligjëruesve nga radhët e komuniteteve.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve MAPL ka mbajtur trajnim dy ditorë me zyrtarë për barazi gjinore në komuna, të mbështetur nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Qëllimi i këtij trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve profesionale, fuqizimi i mekanizmave lokal në fushën e të drejtave të njeriut, gjithashtu rëndësi e veçantë i është dhënë edhe shkëmbimit të përvojave në mes komunave (Prishtinë, Fushë Kosovë, Shtime, Lipjan, Gjilan, Kamenicë, Dragash, Istog, Suharekë, Pejë, Viti, Skenderaj, Obiliq, Podujevë, Gllogoc, Mitrovica e Veriut, Rahovec, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Mamushë).

Në kuadër të mbrojtjes nga Diskriminimi “Promovimi i të Drejtave të Njeriut dhe Parimet e Mbrojtjes nga Diskriminimi në nivel lokal” MAPL është pjesë e projektit nga Zyra për Qeverisje të Mirë – Zyra e Kryeministrit, në partneritet me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe përkrahur nga Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Ky projekt do të zbatohet në 15 komuna, projekti në veçanti ka për qëllim të synojë standardizimin e raportimit për të drejtat e njeriut nëpër komunat e Kosovës,

për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të qytetarëve në këtë fushë. Gjithashtu MAPL është pjesë Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, sipas vendimit të datës 01.06.2022- me nr. 06/2022, ku edhe është mbajtur takimi i parë në promovimin dhe punësimin e komuniteteve në fjalë.

Në ciklin e vizitave në komuna MAPL në bashkëpunim me MBZHR, kanë vizituar komunën e Mitrovicës jugore, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit në mes MAPL, MBPZHR dhe komunës. Me qëllim të monitorimit tek fermerët që të shohin nga afër zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Sa i përket Ligjit për mbrojtje të fëmijës, MAPL ka filluar ciklin e punësimit në regjionet e Republikës së Kosovës. Në mbështetje nga OJQ "Terre des Homes" është mbajtur punësimit e parë regjionale në komunën e Istogut, lidhur me obligimet e komunave që dalin nga Ligjit për mbrojtje të fëmijës, në dy çështje të fokusuara për përcaktimin e zyrtarit për mbrojtje të fëmijës në komunë dhe përcaktimin e zyrtarin në Qendër për Punë Sociale.

5.2. Hartimi dhe miratimi i Planit Nacional të Veprimit 2022 - 2024 në kuadër Partneritetin për Qeverisje të Hapur - PQH

Në kuadër të qeverisjes së hapur si njëri nga parimet themelore të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nismën e MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillohet me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 për qeverise të hapur në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur – PQH. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi ka krijuar dhe funksionalizuar Komitetin Nacional Koordinues, i cili është komitetet gjithëpërfshirës i përbërë nga institucionet relevante publike, organizatat e shoqërisë civile si bashkëudhëheqëse, sektorin e biznesit, organizatat dhe institucionet tjera relevante vendore e ndërkombëtare. Pas procesit të konstituimit të Komitetit Nacional Koordinues për OGP, komiteti i udhëhequr nga MAPL ka zhvilluar 10 takime të komitetit, ka zhvilluar serinë e konsultimeve publike në 7 regjione të Kosovës për hartimin e Planit Nacional të Veprimit (PNV) 2023-2025, si dhe janë zhvilluar 4 punëtori tematike të Komitetit Nacional Koordinues. Në kuadër të këtyre konsultave janë përfshirë më shumë se 250 deri 300 entitete (organizata, institucione, përfaqësues të bizneseve etj). Gjithashtu janë përgatitë për aplikim dy dokumentet bazike ai i vlerësimit të kriterëve minimale dhe letra e interesit. Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 është hartuar ka kaluar në dy proceset e konsultimit paraprak dhe konsultimit publik deri me datën 30 shtator 2022 dhe është miratuar nga Qeveria.

5.3. Zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT

MAPL ka filluar procesin e digitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale duke rritur efikasitetin e këtyre shërbimeve karshi qytetarëve. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi ka krijuar dhe funksionalizuar Këshillin Koordinues, i cili është këshill gjithëpërfshirës i përbërë nga institucionet relevante publike, organizatat e shoqërisë civile, sektorin e biznesit, organizatat dhe institucionet tjera relevante vendore e ndërkombëtare. Në bashkëpunim me DEMOS ka filluar procesi i studimit të fizibilitetit për platformën E-KOMUNAT, si dhe është arritur që të nënshkruhet marrëveshje e bashkëpunimit me Akademinë për E-Qeverisje të Estonisë për zhvillimin e platformës E-KOMUNA. Platforma E-KOMUNAT është përfshirë në dokumentin qeveritar ne Programi për Zvogëlimin e Barrës Administrative dhe është në proces të integritimit në Strategjinë Kombëtare për Digjitalizim. Me 02 shtator 2022 është bërë lansimi i platformës E-KOMUNAT në kuadër të portalit shtetëror E-KOSOVA. Me datën 30 shtator 2022 është publikuar dosja e tenderit në platformën E-Prokurimi për zhvillimin e fazës së dytë të platformës E-KOMUNAT. Platforma E-Komunat është lansuar me 02 shtator 2022.

5.4. Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së



Gjatë kësaj periudhe MAPL-ja ka ofruar informata të vazhdueshme për publikun, mediet, shoqërinë civile, organizatat e huaja ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Kësisoj, në web-faqen e MAPL-së janë publikuar informata, dokumente, njoftime, si vijon: në linkun Lajme - 150 informata, në linkun Aktivitete Ditore - 55 informata, në linkun Vendime - 9 dokumente, në linkun Njoftime për Prokurim - 13 dokumente, në linkun Vende të Lira të Punës - 34 dokumente, në linkun Publikime - 47 dokumente, në linkun Raporte Vjetore të MAPL-së - 13 dokumente, në linkun

Planet Vjetore të Punës së MAPL-së – 4 dokumente, në linkun Performanca Komunale – 76 dokumente, në linkun Rregullat e Grantit – 5 dokumente, në linkun Shqyrtimi i Ligjshmërisë - 596 dokumente, në linkun Udhëzime Administrative – 3 dokumente, në linkun Thirrje për Propozime – 3 në gjuhën shqipe dhe 26 dokumente në gjuhën angleze, në linkun Forumi Konsultativ për Qeverisje Lokale – 1 dokument. Janë përgatitur 240 raporte ditore të monitorimit të mediave, po ashtu 48 raporte të aktiviteteve javore të MAPL-së dhe janë raportuar në Zyrën për Komunikim Publik në Qeveri. Në këtë periudhë është përgatitur raporti gjashtëmujor për reklama në komuna, raporti tremujor për njoftime dhe komunikata në shumë gjuhë për Komisionerin për Gjuhët, raporti tremujor dhe gjashtëmujor i punës për MAPL-në si dhe për Zyrën për Komunikim me Publikun në kuadër Zyrës së Kryeministrit. Në e-mail zyrtar të MAPL-së gjatë kësaj periudhe janë pranuar 67 pyetje nga mediat dhe janë kthyer 67 përgjigje, janë pranuar 102 kërkesa për qasje në dokumente publike të cilat janë trajtuar dhe i'u janë kthyer palëve përgjigje. Gjithashtu, janë pranuar 29 kërkesa të ndryshme dhe janë kthyer 22 përgjigje në kërkesa, janë dërguar 24 njoftime në media, janë dërguar 19 ftesa në media dhe 45 komunikata janë dërguar në media. Janë pranuar 4 kërkesa për intervista/prononcime në media dhe janë realizuar 2. Është dërguar 1 pyetësor tek bizneset në Kosovë si dhe është plotësuar 1 pyetësor. Në rrjetin zyrtar të MAPL-së Facebook janë publikuar 214 informata, 6 infografika, 10 video dhe 4 konferenca. Poashtu, në rrjetin social zyrtar të MAPL-së Tëitter janë publikuar 75 informata si dhe 1 infografikë. Gjithashtu në vazhdimësi Komunave të veriut iu është dërguar kërkesë për raportim për informatat lidhur me gjendjen aktuale të përhapjes së virusit Corona Covid – 19, dhe pas raportimit të këtyre komunave është raportuar në Qendrën Operative Emergjente të Ministrisë së Shëndetësisë.

5.5. Krijimi i platformës së kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore

MAPL në kuadër të ndryshimeve dhe politikave zhvillimore, ka për qëllim të përmirësoj kontrollin e brendshme dhe rritjen e transparencës. Lidhur me zbatimin e projektit (platformës online) për rritjen e llogaridhënies institucionale dhe transparencës buxhetore, ky projekt është bashkëfinansim i Ambasadës Britanike dhe MAPL-së, ku vlera totale e projektit arrin shumën 60 mijë euro, (40 mijë euro nga Ambasada Britanike dhe 20 mijë euro nga MAPL), ndërkaq zbatues i projektit është UNDP. Është funksionalizuar platformës për “Rritjen e kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore të shpenzimeve të fondeve publike të MAPL-së” dhe janë mbajtur trajnimet për zyrtarët e MAPL-së për: modulën e KASH, modulën e buxhetit, modulën kërkesat e mia - udhëtimet zyrtare, moduli i transparencës dhe llogaridhënies, moduli i veturave, moduli i *petty cash*, moduli i projekteve kapitale, moduli i prokurimit dhe moduli i shpenzimeve.

5.6. Platforma e brendshme e raportimit

Ka vazhduar raportimi online në sistemin e integruar të monitorimit dhe raportimit, megjithëse ka pasur ankesa në vazhdimësi nga stafi për mosfunksionimin e kësaj platforme. Në të njëjtën kohë ka vazhduar procedimi i akteve të cilat i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ligjshmërisë.

5.7. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Po ashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me Forumin Konsultativ për Qeverisje Lokale, e cila është 'storie suksesi' dhe si e arritur është përmendur edhe në Raportin e Vendi 2021 për Kosovën nga Komisioni Evropian. Gjatë kësaj periudhe, Forumi ka mbajtur një takim, ku janë diskutuar politikat ligjore të MAPL-së që janë në proces të hartimit, si dhe një takim publik lidhur me konsultimin paraprak publik për konceptin dokumentin për pronën komunale.

5.8. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal

MAPL në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, ka ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna komform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime. Në bashkëpunim me KLG është realizuar trajnimi 2 ditor me temën "Ndryshimet në legjislacionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë" dhe "Matja e Performancës Komunale". Ndërsa në bashkëpunim me IKAP dhe DEMOS është realizuar trajnimi 4 ditorë me sesione trajnuese për procesin përgatitor të raportimit të performancës për vitin 2021. Trajnimi është mbajtur në fushat: Transparenca, komunale, përgjegjshmëria, arsimit parauniversitar, shëndetësia primare dhe barazia gjinore. Në të gjitha këto trajnime, pjesëmarrës kanë qenë 151 zyrtarë komunal. Janë organizuar 6 trajnime konform programit dhe kornizës kohore të planifikuar. Në bashkëpunim me IKAP dhe me mbështetjen e OSBE-së, janë organizuar trajnime 1 ditore në 5 regjionet e Kosovës, lidhur me Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna. Në bashkëpunim me OSBE dhe IKAP në fushën e bashkëpunimit ndër komunal janë realizuar 5 sesione trajnimesh - pjesëmarrës kanë qenë 50 zyrtar komunal. Në bashkëpunim me UNDP është realizuar trajnimi dy ditor në fushën e të drejtave të njeriut me temën "Barazia gjinore" Pjesëmarrës kanë qenë 26 zyrtar komunal. Në 5 sesione trajnimesh për periudhën janar - tetor janë trajnuar gjithsej 289 zyrtar komunal. Në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, është mbajtur trajnimi një ditor për zyrtarët e MAPL-së, "Menaxherët e kontratave, përdorimin e platformës elektronike modulin e Menaxhimit të Kontratës", pjesëmarrës kanë qenë 20 zyrtar të MAPL-së. Në bashkëpunim me IKAP është realizuar trajnimi me temën "Menaxhimi i pronës komunale" pjesëmarrëse kanë qenë 20 zyrtar të MAPL-së. Në bashkëpunim me OSBE është realizuar trajnimi me temën "Komunikimin me media dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe përdorimin e rrjeteve sociale" pjesëmarrës kanë qenë gjithsej 69 zyrtar komunal. Është përgatitur Raporti i Vlerësimit të nevojave për trajnime bazuar në përgjigjet e mara nga pyetësi i dërguar në të gjitha komunat.

VI. Administrata, financat, auditimi dhe prokurimi

6.1. Administrata dhe financat

Gjatë vitit 2022 është bërë përgatitja e fletëpranimit standard të parasë së imët dhe vendosja e të dhënave për kërkesat e bërë për Petty Cash. Janë dorëzuar Pasqyrat Financiare për vitin 2021. Është raportuar në Ministrinë e Financave për periudhën Janar - Dhjetor 2021, për periudhën janar-mars, dhe prill – Shtator. Në vazhdimësi është bërë pranimi i kërkesave iniciuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, regjistrimi i zotimeve dhe i shpenzimeve në SIMFK. Janë pranuar lëndët dhe faturat për procedim të pagesave. Është analizuar dhe harmonizuar me raportet e brendshme barazimi i regjistrimit të shpenzimeve me Departamentin e Thesarit në MF që përfshinë kontrollimin e raportit të SIMFK dhe raportohet në baza mujore. Janë dorëzuar Pyetësi i e vetëvlerësimit, Lista e Rreziqeve, Raporti i planit të punës, raportet e vijueshmërisë, çdo fund jave është dërguar

raporti i buxhetit. Gjatë kësaj periudhe raportuese është përgatitur dhe dorëzuar Draft-Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025. Pas pranimit të Qarkores së pare buxhetore 2023/01 janë mbajtur takimet me SP dhe udhëheqësit e departamenteve për identifikimin e nevojave buxhetore dhe Kërkesa Buxhetore është dorëzuar me datë 23.06.2022 në MF. Pas pranimit të Qarkores së pare buxhetore 2023/01 janë përgatitur PIP-at, dhe janë vendosur shënimet në BDMS. Po ashtu janë dorëzuar: raportet e kontabilitetit për periudhën: Janar-Maj 2022 mbi shpenzimet e përgjithshme, raporti i monitorimit të projekteve kapitale për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe raportet e faturave të papaguar për periudhën Janar-Maj Ministrinë e Financave. Janë kryer të gjitha regjistrimet e pasurisë dhe stoqeve. Gjatë muajit Shtator është përgatitur dhe dorëzuar Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit Gjeneral, si dhe plani i veprimit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike sipas vendimit të qeverisë. Me datë 23.07.2022 është dorëzuar Kërkesa Buxhetore 2023/01 në Ministrinë e Financave. Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur PIP-at për projektet kapitale. Është bërë raportimi për Listën e rreziqeve për periudhën janar -dhjetor 2021 dhe me 13.06.2022 lista e rreziqeve për periudhën janar-qershor 2022. me datë 14.12.2022 është raportuar për periudhën janar-dhjetor. Është bërë raportimi Barazimi i raportit të SIMFK dhe analizimi i tij me raportet e shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2021 dhe në baza mujore për periudhën janar-nëntor 2022.

Buxheti i MAPL-së për vitin 2022, (*bazuar në raport të datës 05.01.2023*) së bashku me Donacionet (*93 Council of Europe dhe WB-Banka Botërore*) është 7,799,564.44 €. Nga kjo shumë, nga buxheti i MAPL-së janë shpenzuar 4,190,507.22 € ose 69.75% e buxhetit. Në kategorinë e donacioneve, nga 93 Council of Europe, janë shpenzuar 155,971.64 € ose 74.97% e buxhetit, ndërsa nga donacioni i WB-Banka Botërore janë shpenzuar 718,933.00 ose 45.41%. Në total Buxheti i MAPL-së dhe Donacionet është shpenzuar në vlerë prej, 5,064,411.86 ose 64.94%.

MAPL për vitin 2022, ka përgatitur 15 procedura të rekrutimit prej tyre tri procedura kanë përfunduar të suksesshme një lëvizje brenda kategorisë një ngritje në detyrë një procedurë me pranim, dhe një procedurë ka dështuar, ndërsa, procedurat tjera janë në proces. MAPL në bashkëpunim me IKAP-in sa i përket fushës së trajnimeve të stafit ka trajnuar gjithsej 29 zyrtarë. Janë hartuar raporte mujore të vijueshmërisë në detaje për secilin zyrtar. Janë realizuar tetëmbëdhjetë (18) kërkesa për ID Kartela të evidentimit. Gjatë kësaj periudhë i kemi realizuar gjithsej 186 kërkesa për ndryshime në paga prej të cilave i kemi: 71 ndryshime, 20 largime nga puna, 8 punëtorë të rinjë, 1 transfer të përkohshëm, 1 transfer i përhershëm, 6 ndërrime të llogarisë bankare dhe 81 pagesa retroaktive, dhe janë hartuar gjithsej njëmbëdhjetë (11) draft vendime për kompensime/shtesa të ndryshme. Gjithashtu, janë përgatitur dy (2) akt emërimi për stafin civil dhe katër (4) akt emërimi për stafin politik. Është përditësuar baza elektronike me të dhëna për stafin e MAPL-së, është bërë menaxhimi i udhëtimeve zyrtare, menaxhimi i pushimeve vjetore, mjekësore. Lidhur me numrin e përgjithshëm të punonjësve në MAPL sipas të dhënave në 2022, numri i punonjësve është 107, prej tyre 17 punonjës janë staf politik dhe 90 shërbyes civil. Prej 90 shërbyesve civil 42 janë meshkuj ose 46.66 %; dhe 48 femra ose 53.34 %. Ndërsa, sa i përket përkatësisë etnike janë: 80 shqiptarë ose 89% 8 serb ose 9 % dhe 2 turq ose 2%. Lidhur me pozitat udhëheqëse, 1 sekretare (zëvendësuese) është grua, 2 udhëheqëse të departamenteve janë gra dhe 9 udhëheqëse të divizionit. Ndërsa burra janë: 3 udhëheqës të departamentit dhe 7 udhëheqës të divizioneve.

6.2. Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka përmbyllur punën e vitit 2021 duke hartuar dhe proceduar të menaxhmenti i lartë i MAPL-së dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQH-AB) raportin e gjashtëmujorit të dytë për periudhën korrik-dhjetor 2021 dhe raportin vjetor për vitin 2021 të punës së NJAB-së. Njësia e Auditimit të Brendshëm në përputhje me Planin vjetor 2022, ka përfunduar auditimet si në vijim:

1. "Menaxhimi i pasurisë në MAPL",
2. "Menaxhimi i listës së pagave në MAPL",
3. "Sistemi i Menaxhimit të Prokurimit".

Është përgatitur dhe proceduar në NJQH-AB dhe te menaxhmenti i lartë i MAPL-së raporti gjashtëmujor i punës së NJAB-së për periudhën Janar-Qershor të vitit 2022 si dhe gjatë kësaj periudhe, janë mbajtur dy takime me Komitetin e Auditimit dhe Menaxhmentin e lartë të MAPL-së. Në proces është Auditimi “*Sistemi i menaxhimit të buxhetit*”, dhe auditimi ad-hoc “*Përmbushja e obligimeve të kontraktuara për mirëmbajtje të ueb faqeve*” që ka filluar më 01.09.2022 me kërkesë të Ministrit.

6.3. Prokurimi

Gjatë vitit 2022, divizioni i prokurimit ka zhvilluar aktivitetet e saj të planifikuara si: **Kontrata për Furnizim** (*furnizim për zyrë, furnizim për zyrë për BNK, furnizim me IT, furnizim me IT për BNK, dhe furnizim me pajisje tjera të IT*), **Kontrata për Shërbime**, (*shërbime për pastrimin e veturave, kontrollimin teknik dhe sigurimin e veturave*).